

# BULETINI I SHKENCAVE GJEOLQJIKE

VITI VIII (XXVI) I BOTIMIT

1  
1989

Tiranë

## TREGUESI I LËNDËS (CONTENTS)

Faqe

### GJEOLLOGJI (GEOLOGY)

- R. Kamberaj, S. Gjoni, Xh. Hadroj. Mbi ndërtimin gjeologo-strukturor të rajonit Rrasë Qerretit (Pukë) ..... 3  
(On the geological-structural construction of the region of Rrasë e Qerretit (Pukë).

### MINERALET E DOBISHME (MINERAL ORES)

- A. Grazhdani. Oreolet e shlihove të plumb-zingut në Albanidet dhe veçoritë mineralogjike të tyre ..... 15  
(Aureoles of lead — zinc schlichs in Albanides and their metallogenetic features).
- D. Shkupi, L. Peza, Gj. Babani. Mineralizimi i hekurit në depozitimet aniziane të rajonit të Vermoshit ..... 25  
(Iron mineralization of the Anizian deposits of the Vermosh region).

### MINERALOGJI-GJEOKIMI-PETROGRAFI (MINERALOGY-GEOCHEMISTRY-PETROLOGY)

- N. Mekshiqi. Varësitë ndërmjet veticë fizike dhe përbërjes kimike të kromshpinelideve të masivit ultrabazik të Tropojës ..... 35  
(Dependence between the physical features and chemical contents of chromespinels of the ultrabasic massif of Tropoja).
- F. Dafa, M. Kedhi: Përcaktimi i elementeve U, Ra, Th, K në depozitimet mesozoike të brezit antikinal të Çikës ..... 51  
Determination of U, Ra, Th, K elements in the Mesozoic deposits of the anticline belt of Çika).
- F. Luli, A. Gjermen. Mineralet argjilore dhe ndikimi i tyre në thithjen e fosfateve nga toka ..... 59  
(Clay minerals and their influence in the absorption of phosphates by the soil).

- Th. Gjata, D. Marku, V. Kici** — Stratigrafia e depozitimeve të verfenianit të sipërm dhe anizianit në rajonin e Vermoshit ..... 65  
 (Stratigraphy of the Upper Verfenian-Anizian deposits of the region of Vermoshi).

### PROBLEME METODIKE (METHODIC PROBLEMS)

- S. Dogjani.** Përcaktimi i peshës vëllimore me metodën radiometrike ..... 81  
 Determination of the volume weight by the radiometric method).

### GJEOLLOGJI-INXHINIERIKE (ENGINEERING GEOLOGY)

- V. Shehu, N. Dhima.** Vlerësimi inxhiniero-gjeologjik i mjedisit shkëmbor magmatik të h/c «Drita e Partisë» Fierzë ..... 87  
 (Geological-engineering evaluation of the magmatic rocky environment fo the «Drita e Partisë» station in Fierze). .

### GJEOFIZIKE (GEOPHYSICS)

- L. Kapllani, B. Çanga.** Disa drejtime të rritjes së efektivitetit të punimeve elektrometrike në mjediset me kontraste të dobta petrografike. 101  
 (Some directions on the growth of effectiveness of the electromagnetic works in the environments with weak petrophysical contrasts).

- A. Frashëri:** Një algoritëm për modelimin matematikor të efektit anomal të të polarizimit të provokuar mbi trupa xeherorë të pasur bakri me trajtë gjeometrike të çfarëdoshme ..... 115  
 (An algorithm for the mathematical modeling of the anomalous effect of induced polarization over the rich copper ore bodies of any geometrical shape).

- A. Kospiri.** Shembuj të llogaritjeve të përbërësve të intensitetit të fushës gjemagnetike ..... 127

### SIZMOLOGJI

- S. Koçaj.** Problemet të ndërtimit të Kores së Tokës në Shqipëri sipas kohëve të hyrjeve të para të valëve gjatësore në stacionet sizmologjike. 137  
 (Problems on the construction of the Earth Crust in Albania according to the time of first onsets of Pwaves in seismologic centres.)



# MBI NDËRTIMIN GJELOGO-STRUKTUROR TË RAJONIT RRASË QERRETIT (PUKË)

**Resmi Kamberaj\*, Stak Gjoni\*, Xhemal Hadroj\***

Në prerjen e Rrasë qerretit (Pukë) vërtetohet moshë Lingjike e kreut të formacionit karbonatiko-silicor dhe vërehet vijueshmëri normale nga formacioni efuzivo-karbonatik (triasik) në formacionët karbonatiko-silicore dhe sipër, në ato vullkanogjeno-sedimentare (jurassic).

## H Y R J E

Në kuadrin e studimit (1) dhe gjatë punimeve gjeologjike të kërkimit për xherorë bakri e zhivë në rajonin e Qerretit (Pukë) (7) u mblohdhën disa fakte lidhur me ndërtimin gjeologo-strukturor dhe vendosjen e mineralizimit në prerjen e formacionit efuzivo-karbonatik e vullkanogjeno-sedimentar. Veç marshut-prerjeve e vrojtimeve sipërfaqësore janë kryer edhe shumë punime minerare dhe shpime, të cilat kanë sqaruar ndërtimin strukturor në thellësi. Në prerjen e Rrasë qerretit vërehet një vijueshmëri normale nga formacioni efuzivo-karbonatik në ato karbonatiko-silicore dhe më sipër në ato vullkanogjeno-sedimentare.

## NDËRTIMI GJELOGJIK I RAJONIT TË RRASË QERRETIT

Në rajonin e Rrasë qerretit (fig. 1) kanë përhapje këto formacione shkëmbore:

### 1- Formacioni efuzivo-karbonatik

Ky formacion përfaqësohet nga gëlqerorë pelítomorf të kuq, grj, tē bardhë, mergelorë, tē kataklazuar, me damarë kalciti dhe me hidroksid hekuri tē ndërthurur me silicorë e rreshpe silicore radiolaritike në formë shtresëzash ose konkrecionesh, tē rikristalizuar, tē shoqëruar shpesh herë me kuarc e okside mangani.

Nga shumica e studjuesve të mëparshëm (1, 2, 3, 4, 8, 9, 10) si ëdhë nga kampionet e marra nga ana jònë (zhveshjet 2282 — 2292) pranohet se ky formacion është me moshë aniziane.

\* Ndërmarrja Gjeologjike në Pukë.

5. Më perspektive është zona e kontaktit të pakos rrëshpore me copa me atë vullkanogjeno-sedimentare dhe nënformacioni efuziv në formacionin efuzivo-karbonatik.

## LITERATURA

1. Bezhani V. etj. 1985 — Studim kompleks tekniko-përgjithsues për sqarimin e perspektivës bakërmajtëse në rajonin Qafë Kingjël — Kçirë — Porav. Tiranë.
2. Bezhani V., Cakalli P. etj. 1986 — Disa kritere gjeologjike të kërkimit të mine-realizimeve sulfure të bakrit në serinë efuzivo-sedimentarë të rajonit Porav Q. Kingjell. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4 Tiranë.
3. Bushati Sh., Mlika I., Osja K. 1981 — Raport gjeologjik me llogaritje rezervash të mineralit të bakrit në v.b. P.
4. Delaj E. 1985 — Rreth gjeologjisë dhe mineralizimit sulfuror të rajonit bakërmajtës Palaj — Karmë. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3, Tiranë.
5. Gjata Th., Kici V., Marku D. etj. 1985 — Studim mbi stratigrafinë e depozitimeve mesozoike (triasiko-jurasike të Albanideve Lindore dhe premisat mineralmbajtëse të tyre) Tiranë.
6. Gjata Th., Kici V., Marku D., Meço S. 1988 — Fakte të reja biostratigrafike që saktësojnë moshën e depozitimeve karbonatiko-silicore të kornizës karbonatike të zonës Mirdita (Albanidet Lindore) Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2, Tiranë.
7. Hadroj Xh., Rrudha S. etj. 1980 — Projekt i përbashkët mbi punimet e kërkimit për mineralizimin sulfuror të bakrit në zonën B.
8. Kodra A. 1984 — Mbi moshën jurasike të formimeve vullkanogjeno-sedimentare në zonën Mirdita. Përmb. Stud. Nr. 2 Tiranë.
9. Kodra A. 1984 — Të dhëna të reja për prerjen e Fushë Lurës. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3, Tiranë.
10. Kodra A., Bakalli F. etj. 1985 — Problematika e formacionit efuzivo-sedimentar të zonës së Mirditës. Konferenca e VI Kombëtare e Gjeologjisë. Tiranë.
11. Kodra A. 1988 — Skemë e zhvillimit paleogeografik e gjeotektonik të Albanideve të brendshme gjatë triasikut e Jurassikut. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4. Tiranë.
12. Nopsca F. 1929 — Geologie und Geographie Nordalbaniens Geol. Ung. — S. Geol. vol. III Budapest.

Dorëzuar në redaksi  
në shtator 1988.

## Résumé

### *La composition géo-structurelle de la région Rrasë-Qerret (Puka)*

Dans la coupe de Rrasë-Qerret, le toit de la formation carbonatique — siliceuse est de l'âge Liassique. On distingue la formation effusivo-carbonatique (effusives Triassiques) et la formation volcanogénée — sédimentaire (Jurassique) avec les horizons de la minéralisation cuprifère respective.

Cette coupe présente une continuité normale de haut en bas:

1. La formation effusivo — carbonatique
2. La formation carbonatique — siliceuse (banc schicteux à morceaux).
3. La formation volcanogénée — sédimentaire

Fig. 1: Schéma géologique de la région Rrasë Qerret (Pukë)

1- ultrabasiques; 2- amphibolites; 3- formations volcanogénéo-sédimentaires;

4- formation carbonatique — siliceuse; 5- formation effusivo — carbonatique; 6- Chevauchement; 7- limite tectonique; 8- limite géologique normale; 9- minéralisations; 10- coupe itinéraire, 11- flysch de la zone Cukali.

Fig. 2: Coupe géologique I Qerret i Vogël

1- carbonatis; 2- siliceuses; 3- basaltes diabasiques, à titane-angite; 4- zone minéralisée; 5- banc schisteux à morceaux; 6- ultrabasique; 7-failles; 8- forages.

Fig. 3: L'affleurement de Rrasë — Qerret

Fig. 4: Coupe géologique Drin — Qerret

1- flysch de la zone Cukali; 2- ultrabasiques (Serpentinites); 3- formation volcanogénie — sédimentaire; 4 — formation carbonatique — siliceuse; 5- formation effusivo-carbonatique; 6- Chevauchement; 7- failles; 8- indice minéralisé; 9- numéro de l'affleurement.

Fig. 5: Coupe géologique à Pérroi i Marrajt (Rrasë Qerret)

1- basaltes diabasiques: a) triassiques; b) jurassiques; 2- hyalo-albitophyres chloritisées; 3- calcaires dolomito-sparithiseux, siliceux, 4- schistes siliceux radiolaritiques; 5- siliceux rouges, marrons, noirs à taches d'oxydes de manganese; 6- éléments d'étension; 7- numéro d'affleurement; 8- déterminations d'âge; 9- Failles.

Fig. 6: Coupe géologique Pr. Guri i Zi — Pr. Kçire  
(conventions co à la Fig. 5)

Fig. 7: Corrélation de quelques coupes diverses de la région de Rrasë-Qerret à celles de la région Poravë et Geraj-Palaj.

Fig. 8: Colonne Stratigraphique de la région Rrasë — Qerret

## OREOLAT E SHLIHOVE TË PLUMB-ZINKUT NË ALBANIDET DHE VECORITË METALOGJENIKË

Andon Grazhdani\*

Përgjithësohen rezultatet e rilevimeve në shliho për mineralet e plumbit dhe të zingut për gjithë vendin tonë, simbas zonave tektonike dhe jepen formacionet e mundshme xherore.

Gjatë rilevimeve gjeologjike (4, 6, 7, 15, 16) dhe kërkimeve të specializuara (6, 10, 19) të kryera në gjithë territorin e vendit tonë, janë përcaktuar oreola të shumta të plumbit dhe zingut. Oreolat përfaqësohen kryesisht nga galeniti dhe sfaleriti, por për plumbin shpesh herë takohen edhe mineralet dytësore hipergjene si ceruziti  $PbCO_3$ , vulfeniti  $Pb(MoO_4)$  dhe piromorfiti  $Pb_3(PO_4)_3Cl$ , që formohen në zonë të tjetërimit sipërfaqësor të galenitit. Ceruziti takohet gati në të gjitha zonat tektonike, kurse vulfeniti e piromorfiti vetëm në zonën e Korabit. Këto oreola në shumicën e rasteve janë shumë të fuqishme dhe përfaqësojnë interes praktik për studime të mëtejshme.

Duke u bazuar në përgjithësimin e kryer për këto oreola në kuadrin e studimeve për hartën metalogjenike të RPSSH në shkallë 1 : 200 000 po bëjmë një vlerësim të tyre duke i studuar në kompleks përbërjen, shoqërimet minerale, kushtet e lokalizimit me evolucionin gjeologo — tektonik të njësive të caktuara. Mbi këtë bazë do të jepen tipat e mundshme gjenetike për të orientuar studimet e tyre.

Oreolat e shlihove të galenitit dhe sfaleritit i takojmë të përqëndruar në sektorë të veçantë në të gjitha zonat tektonike. Në zonën e Korabit në pjesën veriore predominojnë oreolat e fuqishme të galenitit, më pak të sfaleritit, si në Shishtavec, Kolesian — Ujmishi dhe Buzëmadh — Cajë. Ndërsa në pjesën jugore takohen oreolat e sfaleritit me më pak galenit, si në Sllovë-Kastriot etj.

Në zonën e Gashit mbizotërojnë oreolat e galenitit më me pak sfalerit si në Vermosh, Cerem, lumin e Gashit etj. Ndërsa në zonën Mirditë janë më të zhvilluara oreolat e sfaleritit si në Kabash, Qafë Mali, Kodrës së Kuqe, Spaçirt, Perlatit, Peshqeshit etj. Në nënzonën e Kras-tës janë të njohura shumë oreola të rendit më të lartë të thjeshtë sfaleritit, si oreola e Taraboshit, Krajnit, Droje — Cuhim — Bastarit, Erzenit, Kuratës etj. Vetëm në oreolën e Krajnit krahas sfaleritit takohet

\* Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave në UT «ENVER HOXHA»

## Analiza spektrale e sfaleritit nga shlibot (në %)

Pasqyra Nr 1

Elementet përberës	ZONAT TEKTÔNIKA						
	KRASTA	CUKALI	MIRDITA KACINAR	MIRDITA MUNELLA	KORABI	GASHI CEREMI	LUMI I GASHIT
Fe	0,1–0,3	0,5	12	5–20	0,5	0,1–0,5	10
Mn			00,4–0,2	0,1	0,05	0,1	0,1–0,2
Ni	0,001			0,0006			0,00001
As		0,01	0,5–1	0,01–0,5	0,05	0,5	0,001
Cd	0,1–0,3	0,1–0,2	0,03–0,1	0,04–0,1	mni 1	0,1–0,5	0,01–0,05
Cu	0,1	0,01	0,1	0,01–2	0,05–0,1	0,01	0,1
Co	0,003	0,005	0,001	0,002		0,06	0,02
Pb	0,005	0,002	0,002	0,01		0,5	0,002
Te		0,0001					
Mo			gj	4.10 <sup>-5</sup> –0,001			gj
Sn	0,002–0,003	0,002	0,005	0,0006		0,005	0,0001
Bi				0,001	gj	0,001	
Ag		5.10 <sup>-5</sup>	5.10 <sup>-4</sup>	0,0008–0,02			
Ge	0,003	0,001		0,002–0,01			

Analizuar nga Ll. Pashko.

2- Në vendin tonë në fazat e ndryshme orogenike metalo-metrike, përcaktojmë këto formacione të mundshme kryesore xehore:

Në ciklin paraorogenik të fazës ardene, formacionet e pritshme sulfurmabajtëse të rreshpeve të zeza, të ngopura me lëndë organike të ordovik — devonianit, në zonën e Korabit.

Në fazën sudete — palatinase ndodhet formacioni hidrotermal kuarc — sulfur me monconite — sienitet dhe kuarc — dioritet e karbon — triasikut, në zonën e Korabit dhe formacioni terigjen sulfurmabajtës i karbon-permit në Gash.

Në fazën palatinase formacionet e pritshme polimetalar të lidhura me vullkanizimin bazik të zonës së Korabit dhe formacioni pirit kalkopirit — sfalerit midis shkëmbinjve vullkanogjeno-sedimentar të triasikut të poshtëm të zonës së Gashit.

Në fazën paspalatinase, formacioni polimetalar me cinabarit të lidhur me dacitet dhe andezitet e triasikut të mesëm në zonën e Gashit (Vermosh).

Me fazën orogenike kimerike lidhen disa formacione xehore të njohur në shkëmbinjtë ofiolitike të zonës Mirdita.

Me fazën pirinejase, save dhe ndoshta deri në stiriane lidhen formacionet e pritshme të sfaleritit dhe sfalerit — galenitit të zonës së Krastë — Cukalit dhe të asaj Jonikes;

## L I T E R A T U R A

1. Bajo I 1984 — Evaporitet e zonës Jonike, dukuritë diaplikë të tyre dhe perspektiva e mineraleve të ngurtë në strukturat që formojnë ato. Dizertacion.

2. Çakalli P. Bezhani v. 1983 — Disa mendime për gjeologjinë, për ndërtimin strukturor dhe për mineralizimin sulfur të brezit lindor të zonës së Mirditës. Bul. Shkenc. Gjeol. Nr. 3.
3. Çina A. 1988 — Mineralizimet sulfure e arsenure në shkëmbinjtë ofiolitikë bazikë dhe ultrabazikë të Albanideve Bul. Shkenc. Gjeol. Nr. 1.
4. Çobo X. Vllaho J. Kasapi S — 1985 — Ndërtimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme të rajonit Sukaxhi — Kaçinar — Kushnan.
5. Duro A., Duka V., Nikolla M 1984 — Fluoriti në shkëmbinjtë, karbonatike. Bul. Shkenc. Gjeol. Nr. 2.
6. Grazhdani A 1981 — Perspektiva e kërkimit të mineralizimit të zhivës në dy anët e thyerjeve Shkodër-Tropojë. Disertacion.
7. Grupi i përgjithësimit — Hartat e shlihove të shkallës 1:25000 të sektorëve Vermosh, Gash, Lumë, Veleshicë, Kurvelesh, Gramsh, Fondi i N. Gjeol. Tiranë (1985-1987).
8. Gjata K. Kodra A. 1982 — Magmatizmi pasofiolitik jurasik — kretak dhe ai më i ri mesataro — acid në vendin tonë. Bul. shkenc. Gjeol. Nr. 4.
9. Gjata K. 1975 — Karakteri i mineralizimit në depozitimet paleozoike të pjesës veriperëndimore të zonës së Gashit Përbledhje Studimesh Nr. 3.
10. Gjata K. Kodra A. Zhukri G., Mustafa F., Aliaj Q. 1985 — Studimi tematik dhe punimet e kërkimit për sqarimin e perspektivës për mineralet të rrallë në vendin tonë.
11. 1986 — Harta e shlihove e RPSSH 1:200 000 Tiranë. (Ndërtuar në kuadrin e Hartës Metalogenike të RPSSH).
12. Hoxha L 1981 — Rregullsitë e përqëndrimit të mineralizimeve sulfure në shkëmbinjtë vulkanogjene të Mirditës Qendrore (rrethi i Mirditës) dhe perspektiva e mëtejshme e kërkimit. Disertacion.
13. Kati P 1969 — Fluoriti dhe bariti në zonën e mineralizuar të Qafë Barit. Përbledhje Studimesh Nr. 7.
14. Kodra B. Meshi N 1986 — Studim teorik përgjithësues i rilevimit kompleks për sqarimin e perspektivës së mineraleteve të Fe dhe mineraleteve të tjera në rajonin e Radomirës.
15. Liko V. 1960 — Ndërtimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme të rajonit të malit të Skënderbeut dhe periferisë së tij.
16. Mehmeti B 1977 — Mbi rezultatet e rilevimit shlihor në shkallën 1:50 000 për rajonin Gjazuj — Ceruje — Korgë dhe Leskovik.
17. Ndoja I. Gj. Bakalli, Gjata K 1972 — Mendime mbi mineralizimet polimetaloore në vendin tonë. Përbledhje Studimesh Nr. 4.
18. Ostrosi B. 1978 — Metalogenia dhe strukturat e fushave xeherore.
19. Sinoimeri Z. Buda V, Turku A etj. 1981 — Studimi përgjithësues mbi disa tipa të mineralizimeve (polisulfure) në vendin tonë.
20. Shallo M 1969 — Disa veçori të ndërtimit gjeologjik dhe të mineralizimit sulfid të rajonit të Munellës. Përbledhje Studimesh Nr. 2.
21. Shallo M. 1970 — Mbi problemin e magmatizmit acid në Shqipëri Bul. USht. Seria e Shkencave Natyrore Nr. 4.
22. Shallo M. Cina A 1975 — Mineralizimi damaror kuarc — sulfuror i bakrit në masivin gabror të Kaptinës. Përbledhje Stud. Nr. 3.
23. Tashko A., Iljazi S., Luli A. 1975 — Raport i punimeve gjeokimike për kërkimin polimetaleve në rajonin Labinot-Guri i Bardhë (zona e Krastë-Cukalit).
24. Dronnik M. Duhovnik J 1981 — Cinkovo svinceno rудисce Zavr. Rud. mest. 28-1981.

25. Cassedanne J 1981 — Etude de quelques alluvions stannifères à bahianite esko-laite. An. Acad. Brasil ciens 53.
26. Hutchison Ch 1983 — Economic Deposits and the Tectonic Setting.
27. Mithehell A.H., Carson MS 1984 — Globalnaja tektoničeskaja pozicija mineralnih mestorozhdenij.
28. Pajoric M. 1986 — Non Ferrous distribution in stream sediments from Bjeljesica Montana and it's metalogenetic importance Geol. glasnik Titograd.
29. Jankovic S 1977 — Major Alpin ore deposits and metalogenic units in the NE Mediterranean and concepts of plates tectonice.

Dorëzuar në redaksi  
gushi 1988.

#### *Summary*

Numerous secondary aureoles of schlichs (heavy concentrate) in the stream sediments of zinc and lead through all the tectonic zones of our country have been determined during the geological plottings and specialized works. The sphalerite and galenite are the main minerals in the schlichs. The cerusite, wulfenite and pyromorphite have been encountered in schlichs as hypogene secondary minerals.

The aureoles of schlichs of sphalerite and galenite occur through all the tectonic zones of Albanides. They are concentrated in some individual sectors and their study is not difficult. Some aureoles are of sphalerite only and some others mainly of galenite with sphalerite as accompanying mineral. Thus, in general, the aureoles of the Korabi and Gashi are distinguished for the higher contents of galenite, while, the Krasta and Mirdita ones distinguish for the higher contents of sphalerite. All the aureoles are important, but the following ones are more important to further study: the aureoles of galenite of Shistavec and Buzemadhe, of sphalerite of Sllove (Korabi zone) the aureolas in the sector of Cërujë-Shkallë between the ultrabasic rocks (Mirdita zone), the strong sphalerite aureolas in Tarabosh, Krajn, Cudhië, Bastar, Erzen, Kurate (Krasta subzone), the aureolas of galenite and sphalerite of Kiri (Cukali subzone) etc.

From the analysis of geological factors we can reach to the conclusion that the following possible main ore formations can be distinguished in our country during the different metallometric orogenic stages:

- In the pre-orogenic cycel of the ardene stage, the sulphide-bearing of black schists saturated with the Ordovician-Devonian organic matter in the Korabi zone.
- In the sudeete-palatine stage occur the Carboniferous-Triassic hydrothermal quartz-sulphide formation with monzonite sienites and quartz diorites in the Korabi zone and the Carboniferous-Permian terrigenous sulphide-bearing formation in Gash.
- In the Palatine stage, the polymetalliferous formation linked with the basic volcanisms of the Korabi zone and the pyrite-chalcopyrite-sphalerite formation between the volcano-sedimentary rocks of the Lower Triassic of the zone of Gashi.
- In the post-Palatine stage, the polymetallic formation with cinabarite linked with the dacites and andesites of the Middle Triassic in the zone of Kashi (Vermosh).
- Some known ore formations in the ophiolitic rocks of the zone of Mirdita are linked with the Kimerian orogenic stage.
- The formations of sphalerite and sphalerite-galenite of the Krasta-Cukali, Ionian and Mirdita zones are linked with the pyrenean, save and, perhaps, to styrian stage.

## *Mineralat e dobishme*

# MINERALIZIMI I HEKURIT NË DEPOZITIMET ANIZIANE NË RAJONIN E VERMOSHIT

Dëfrim Shkupi\*, Luftulla Peza\*, Gjon Babani\*\*

Mineralizimi i hekurit në rajonin e Vermoshit gjëndet brenda depozitimeve karbonatike aniziane dhe përfaqësohet kryesisht nga hematiti dhe më pak nga magnetiti. Jepen të dhëna të shkurtër gjeologjike, përshkruhet mineralizimi dhe trupi kryesor i hekurit dhe mendime për gjenezën.

### H Y R J E

Kërkimi i hekurit ka rëndësi të madhe, prandaj kujdesi i gjeologëve tanë prej vitesh eshtë përqëndruar në këtë drejtim. Deri tani objekti më i rëndësishëm për hekurin pa nikel eshtë gjetur në rajonin e Vermoshit.

Studimi më i hershëm për ndërtimin gjeologjik dhe mineralizimin e rajonit të Vermoshit eshtë kryer në aksionin gjeologjik me goditje të përqëndruar në Alpe (S. Dede etj. 1972). Pas vitit 1972, nga gjeologët e Nd. Gjeologjike të Shkodrës, rajoni i Vermoshit ka qenë objekt i shumë studimeve sidomos për polimetale, zhivë etj. Gjatë vitit 1975 dhe më vonë janë kryer punime kërkim-vlerësimi për polimetale e zhivë, të shqëruara me punime komplekse gjeologo-gjeofiziko-gjeokimike nga gjeologët S. Bakri, E. Delaj, K. Treska, S. Rrudha, M. Malaveci etj. Përvetës këlyre janë kryer studime mineralogjike e petrografike, nga specialistët H. Tuzi (1979) dhe A. Duraj (1979).

Në vitet 1979 — 1985 në objektin S. u kryen punime gjeologo-zbuluese për zhivë nga S. Bakri, E. Delaj e Gj. Babani.

Punimet gjeologo-zbuluese intensive në këtë rajon për vlerësimin e hekurit kanë filluar në vitin 1982 dhe vazhdojnë edhe sot nga ekspedita gjeologjike e ndërmarrjes së Shkodrës, të drejtuara nga gjeologu I. Doçi dhe së fundi nga Gj. Babani. Gjatë viteve 1986-1987 u kryen punime stratigrafike në depozitimet mesozoikë të rajonit të Vermoshit dhe u gjurmua dhe u vrojtua horizonti hekuror që lidhet me këto depozitime (Peza L. etj. 1988). Nga këto punime u saktësua pozicioni stratigrafik ho-

## P E R F U N D I M E

1. Mineralizimi i hekurit në rajonin e Vermoshit përveç se në sekitorin e Majës B ndeshet dhe në Kërshin e Djegur, dhe tepër i dobësuar në sektorin e Vuçinit, duke formuar brenda depozitimeve aniziane një horizont kryesor hekurore. Përvç kësaj brenda formimeve vullkanogjeno-sedimentare ka shfaqje hekurore me të vogla si në Polloverce etj.

Mineralizimi hekurok kryesor mendojmë se është i tipit sedimentar. Ndërsa ai që takohet në Polloverçë etj. ka origjinë vullkanogjeno-sedimentare.

2. Trupi mineral përbëhet nga xehlerorë masivë dhe me pikëzim të mineralizimit hekurok, me forma shtresoro — thjerëzore, me ndryshime të theksuara të trashësisë gjatë shtrirjes e rënies.

3. Punimet gjeologo-zbuluese rekomandojmë të orientohen në horizontin kryesor hekurmabjtës gjatë gjithë shtrirjes së krahut jugor të sinklinalit të Vermoshit (të depozitimeve triasike), që nga Maja B në Kërshin e Djegur, e deri në Vuçin.

Me punime duhet të kontrolllohen edhe shfaqjet më të vogla të hekurit që gjenden në rajonin e Vermoshit brenda formacionit vullkanogjeno-sedimentar ose mbi të (Polloverçë, Përbicë etj.).

## L I T E R A T U R A

1. *Bakri S. etj. (1977) — Projekt mbi punimet e kërkim-revizonimit në zonën e Vermoshit për vitin 1977. Shkodër.*
2. *Doçi I., Kosho P. etj. (1986) — Projekt mbi punimet e kërkim-vlerësimit dhe zbulimit paraprak në objektin e hekurit Shkodër.*
3. *Grillo V., Turku I., Bakri S., Nikolla M. (1983) — Studim tematiko-përgjithësues e rilevues për kërkimin e polimetaleve në rajonin Dukagjin — Verëmosh, Tiranë.*
4. *Gjata Th., Kiçi V., etj. (1985); — Studim mbi stratigrafinë e depozitimeve mesozoike triasiko-jurasike të Albanideve lindorë dhe premisat për mineralmbajtjen e tyre. Tiranë.*
5. *Peza L.H., Shkupi D., Turku I., Terolli I. (1988) — Stratigrafia, paleogeografi dhe konkretizimi i perspektivës për hekur në zonën e Vermoshit. Tiranë.*
6. *Dimroth E. (1976) — Aspects of the sedimentary petrology of cherty iron-formation (në: Hand-book) of strata bound and stratiform ore deposits, volume 7, Elsevier.*
7. *Holland H.D. (1973) — The oceans: a possible source of iron in iron formation. Econ. Geol., vol. 68.*
8. *James H.L. (1954) — Sedimentary facies of iron formation. Econ. Geol., vol. 49.*
9. *Pavlovic C.P. (1960) — Nalazak hanbuloske faune u hematitu Smreke Varesha u Bosni. Geol. AN. Balk. Pol., kn. XXVII, Beograd.*
10. *Quade H. (1976): Genetic probleme and environmental features of volcano-sedimentary iron ore deposits of the Lahn Dill-type (Hand-book of strata-bound and stratiform ore deposits, vol. 7, Elsevier.*
11. *Veizer J. (1976): Evolution of ores of sedimentary affiliation through geologic*

history: relation to the general tendencies in evolution of the crust hydrosphere, atmosphere and biosphere. (Në Hand-book) of strata-bound and stratiform ore deposits, vol. 3, Elsevier.

Dorëzuar në redaksi  
në qershor 1988.

### S u m m a r y

#### *Iron mineralization in the Anisian deposits of the Vermoshi region*

This article treats some problems of the iron mineralization in the Vermoshi region. The geology of this region is briefly given here. The Lower-Middle Triassic carbonaceous deposits and volcanic rocks occur there. Two mineralized horizons have been distinguished in the above mentioned region.

The main mineralization is linked with the Anisian carbonaceous deposits and has a sedimentary origin, whereas the second one is linked with the volcano-sedimentary formation and has volcano-sedimentary origin.

The mineralization of the main horizon is of the hematite type. The manganese mineralizations occur in small amounts together with them.

The mineral body is composed of the massive and disseminated ores of the thickness through the extention and dipping.

Fig. 1. Stratigraphical position of iron mineralization in the Vermoshi region (the main horizon).

1. Stratified limestones; 2. Marly limestones; 3. Massive limestones; 4. Banded limestones; 5. Brecciated limestones; 6. Highly ironiferous limestones; 7. Conglomeratic limestones; 8. Dolomites; 9. Marls; 10. Shales; 11. Radiolarites; 12. Volcanics (andesites); 13. Rhyolites; 14. Tuffites; 15. Iron horizon.

Fig. 2. Outcrop of the iron horizon in the summit B.

1. Limestone; 2. Mineral zone; 3. Hematitic mineralization.

Photo 1. The contact of the hematitic ore with the mineral zone.

- a. Mineral zone; b. Hematitic ore; c. Contact.

## Mineralogji-gjeokimi-petrografi

# VARËSITË NDËRMJET VETIVE FIZIKE DHE PËRBËRJES KIMIKE TË KROMSHPINELIDEVE TË MASIVIT ULTRABAZIK TË TROPOJËS

Nezir Mekshiqi\*

Duke u bazuar në studimin e bashkëlidhjes ndërmjet vëgorive fizike të kromshpinelideve dhe përbërjes kimike, është vënë në pah prania e disa niveleve xehorore, gjë që mbështetet edhe me të dhënrat analitike dhe mendimet e shfaqura nëpërmjet studimeve gjeologo-strukturore e petrologjike për këtë problem në masiv. Ky studim mineralogjik, në gërshetim edhe me studimet e tjera, do të ndihmojë për vlerësimin e krombajtjes së masivit ultrabazik të Tropojës për orientimin e kërkimeve gjeologjike në të.

### H Y R J E

Nga studiues të ndryshëm (G.A. Sokollov, A.N. Vinçell, M.N. Ponamavjera dhe N.V. Pavllov) janë përcaktuar varësitë ndërmjet densitetit, aftësive reflektuese, mikrofortësisë, përshkrimit të valëve të dritës me gjatësi të caktuara, parametrit të celulës elementare të kromshpinelideve dhe përbërjes kimike të tyre.

Në vendin tonë, për masivin e Bulqizës, janë kryer studime nga autorët (11, 2, 3) për sjellshmërinë e vartësisë ndërmjet vetine fizike dhe përbërjes kimike të kromshpinelideve për trupa të ndryshëm.

Në këtë artikull do të analizojmë lidhjet e përbërjes kimike të kromshpinelideve aksesore e xehororformuese dhe të vetine fizike të kromshpinelideve në xehororët e masivit ultrabazik të Tropojës.

Gjatë studimit mikroskopik të kromphinelideve të masivit vihet re, që, në dritë të përshkuar gjatë vrojtimit në shlife, kromshpinelidet kanë ngjyrë të ngjashme me të ullirit, kafe deri kafe të kuqe dhe të zezë, sipas përbajtjes së komponentëve përbërës në ta. Në llojet me përbajtje më të lartë  $FeO$ ,  $Fe_2O_3$  dhe  $Cr_2O_3$  ngjyra është e errët, ndërsa në llojet e metamorfizuara ngjyra bëhet e zezë. Në dritë të reflektuar

---

\* Ndërmarrja Gjeologjike në Tropojë.

### Vëndet e marrjes së provave

17. Zgjec, Mësivi i Tropojës
37. Trupi nr. 1, Kam masiv i Tropojës
23. V. Zogaj — 3, masivi i Tropojës
67. Çoraj trupi nr. 1, masivi i Tropojës
- 2<sup>s</sup> Nr. 10-58, fusha e Donit
19. Vendburimi Zogaj, trupi -1, masivi Tropojës
83. Cobrat 1, masivi i Tropojës
- 11<sup>s</sup> Nr. 734 — 6, masivi i Tropojës
- 8<sup>s</sup> Nr. 700-60, masivi i Tropojës
44. Trupi nr. 2, Kepenek fushat? masivi i Tropojës
53. Trupi nr. 1, Kepenek — 1 masivi i Tropojës
84. Cebrat — 1, masivi i Tropojës
9. Mahall qafe, masivi i Tropojës
- 3<sup>s</sup> Nr. 402-61, CKX 79-G
30. Lugu i zanit, masivi i Tropojës
94. Lugu i derashve, masivi i Tropojës
69. Nr. 135-60, masivi i Tropojës
22. VB. Zogaj-2, masivi i Tropojës
88. Aksesor kromi në dunit, Lugu i zi masivi i Tropojës
28. Mahall qafa jugore, masivi i Tropojës
75. Stohrdë masivi Tropojës
78.                  >                  >
- 73.

### LITERATURA

1. Çina A. 1970 — Mbi mineralogjinë dhe prejardhjen e kromshpinelideve. Tiranë.
2. Çina A. 1984 — Disa veçori fizike të kromshpinelideve xehore të përbërjes së masivit ultrabajzik ofiolitik të Bulqizës. Buletin i Shkencave Gjeologjike Nr. 4, Tiranë.
3. Dede S. 1977 — Përbërja kimike dhe fenomenet e iziomorfizmit të mineraleve të kromshpinelideve xehorformuese e aksesore të masivit ultrabajzik të Bulqizës. Përmblidhje Studimesh Nr. 3, Tiranë.
4. Pavlov N.V. Grigorieva I.S. 1974 — Mestorozhdjenia hroma — Rudnie mestorozhdenia SSSR. Tom. 1, Moskva.
5. Pavlov N.V. 1967 — Sostav kromshpinelidov i genetiçeskie tipi hromitovo orudenia Kempirsajskova plitstone. Geoll. Rud. Mjestorozhd., nr. 2.
6. Panagos A.G. — 1967 — Des Reflecionvermogen der chromite von vourinon und ihr Zusammenhang mit der Geologie des cebietes. Athen.
7. Winzell A.N. Winzell G. 1951 — Elements of optical Mineralogy New York.

Dorëzuar në redaksi  
në qershor 1988.

### Summary

#### *Dependence between the physical features and the chemical contents of chromespinels of the ultrabasic massif of Tropoja*

The physical features of chromespinels such as density, the reflective abilities, microsolidity, penetration of the light wave with the definite length and the parametre of the elementary cell of chromespinels have been examined depending on all components. The component elements of chromespinels, according to their features, are classified in the following two groups: metallogenetic elements Cr, Fe<sup>+2</sup>, Mn and petrogenic ones (Al, Mg). The physical features of chromespinels depend not only on the contents of Cr, Al atoms, but also on the contents of the atoms of other elements: the contents of Fe<sup>+3</sup>, Fe<sup>+2</sup>, Mg, Mn.

From measurements of the parametres of elementary cell of the accessory chromespinels and ore components of the ultrabasic massif of Tropoja result that the limits ranges from 8.255 to 8.327 Å°. Referring to the chemical contents and calculating Cr+Fe<sup>+2</sup>+Fe<sup>+3</sup>+Mn and Mg+Al shown on the generalized diagramme (fig. 1, a) it results that in the massif for highly ironiferous chromites the expected values must be  $a_0 = 8.295 - 8.333$  Åo. At the present stage, on the bases of the diagram, it results that the chromespinels, in general, have minimum values  $a_0 = 8.19$ , R = 10.25, D = 4.05 for Cr + Fe<sup>+2</sup> + Fe<sup>+3</sup> + Mn = 35 and Mg + Al = 65. The maximum values are  $a_0 = 8.32$ , R = 13.60, D = 4.65 for Cr + Fe<sup>+2</sup> + Fe<sup>+3</sup> = 80 and Mg + Al = 20. Based on the chemical analyses, the ultrabasic massif of Tropoja has the following values: Cr + Fe<sup>+2</sup> + Fe<sup>+3</sup> = 54.41 — 78.90 and Mg + Al = 21.10 — 45.59 to which correspond the values of Qo = 8.255 — 8.333, R = 12.05 — 13.60, D = 4.30 to 4.65. About 90% of analyses show Cr + Fe<sup>+2</sup> + Fe<sup>+3</sup> = 60 — 73 and Mg + Al = 27.40 to which correspond the values of Qo = 8.272 — 8.3102, R = 12.50 — 13.60, D = 4.36 — 4.53.

The calculated density of chromespinels varies from 4.31 to 4.65. In the ultrabasic massif of Tropoja, the compound accessory and ore chromespinels with D = 4.46 — 4.65 are highly ironiferous.

On the diagram (fig. 1, abc) it is clearly seen that the lowest values of qo, D, R have chromespinels with high Mg + Al (in atomic %) and the highest values have the compound chromespinels of the massif with high Cr + Fe<sup>+2</sup> + Fe<sup>+3</sup> + Mn.

Based on the correlation between the physical composition and the chemical contents, five groups with the respective division have been distinguished within the analysed chromespinels.

Fig. 1. Correlation between the parametres of the elementary cell (a, Å) reflective indicator (R%), density of chromespinels (D) and chemical contents of accessory and ore component chromespinels.

Accessory and ore-component chromespinels situated in serpentinites (after dunites) or in the serpentinites of gabbro-pyroxenite-serpentinite stratifications, which are highly ironiferous, localized in the formation of ultrabasic cumulates such as Bregu i Bibës, Stoberdë.

Ore component chromespinels situated through a wide field of the spreading or dunites, localized at the ultrabasic cumulate formation, which are relatively ironiferous.

Ore component chromespinels localized at the uppermost parts of harzburgites of the formation of ultrabasic tectonites, in thick intercalations of dunites with harzburgites, transitory to the formation of ultrabasic cumulates.

Ore component chromespinels situated through the harzburgite masses, in the very thin intercalations or «dunitic shirts» of podiform bodies of the formation of ultrabasic tectonites.

Ore component chromespinels situated at the thick dunite bands of the field composed of fresh and serpentinized harzburgites or localized in harzburgites (fresh) with «dunitic shirt» in the formation of ultrabasic tectonites.

Accessory chromespinels localized in the field of the spreading of harzburgites.

Ore component chromespinels localized at the Bulqiza massif.

Ore component chromespinels localized at the massif of Kempirsaj etc., Ural.

# PËRCAKTIMI I ELEMENTEVE U, Ra, Th, K NË DEPOZITIMET MESOZOIKE TË BREZIT ANTIKLINAL TË ÇIKËS

— Ferdinand Dafa\*, Mario Kedhi\*\*

Jepen për herë të parë, në mënyrë të përbledhur përcaktimet e përbajtjeve të izotopëve U, Ra, Th, K në depozitimet mesozoike të brezit antiklinal të Çikës. Bëhet vlerësimi i tyre sipas kompleksit dolomitik, karbonato-silicor dhe atij flishoidal. Përcaktohen nivelet me përbajtje izotopike më të lartë.

## H Y R J E

Në natyrë izotopet radiokativë të familjeve të uranit dhe të toriumit, kimikisht të ndryshëm nga njëri-tjetri, në mjeshter gjeologjike si-përfaqësore dhe afër sipërfaqësore të lëmshit të dheut, në përgjithësi ndodhen jo në ekuilibër radioaktiv. Disekuilibri shkaktohet nga bashkëveprimet kimike dhe fizike që ndodhen në mjeshtësi. Studimi i këtij disekuilibri e veçanërisht përfshin e uranit së bashku me përcaktimin e kaliumit  $K^{40}$  paraqet interes të veçantë në gjeokimi. Ai lejon jo vetëm përfshirje e gjurmuar sjelljen e këtyre izotopeve në mjeshtësi, por dhe përfshirje datuar ngjarje të historisë së tokës me saktësi deri në rreth 1 milion vjet. Interes të veçantë paraqet gjithashtu ekuilibri midis Ra-226 dhe U-238. Kjo gjen një përdorim të gjerë në kërkimet e vendburimeve të uranit.

Përfshirja e izotopeve të familjeve të uranit dhe thoriumit si dhe të elementit kalium, krahas metodave të tjera analizuese, një përdorim të gjerë ka gjetur dhe ajo e spektrometrise gama. Kjo në fillim me dedektor NaI dhe më vonë kryesisht me dedektor gjysëmpërçues. Në këtë artikull po jepim në mënyrë të përbledhur përcaktimet e përbajtjeve të elementeve U, Ra, Th, K, në depozitimet e brezit antiklinal të Çikës. Nga punimet e deritanishme gjeologo-radiometrike të kryera në depozitimet mesozoike të zonës Jonike është përcaktuar intensiteti integral i shpërndarjes së elementeve radioaktive.

\* Ndërmarrja Gjeofizike në Tiranë.

\*\* Instituti i Fizikës Bërthamore në Tiranë.

Argjilat, alevrolitet, shistet argjilore-mergelore kanë përmbajtje më të ngritur të kaliumit. Në to kaliumi arrin deri 5.4% (10).

— Metodika e përdorur në këtë studim, lejon matjen dhe të përmbajtjeve të ulta të izotopeve radioaktivë natyror. Ajo mund të përdoret për studimin e diferencuar të këtij radioaktiviteti dhe për zona të tjera gjeologo-tektonike të vendit tonë.

— Nga matjet veçmës të izotopeve radioaktive të U, Ra, Th dhe K, në prerje veçojmë tre nivele kryesore me përmbajtje të ngritur të tyre: Niveli i parë i përket pranisë së shisteve bituminoze djegëse; niveli i dytë lidhet me fosforitet jurasike të dogerit që lidhen me pushimet stratigrafike dhe niveli i tretë është ai i horizontit fosfatik kretak (konjakian). Më me interes paraqitet niveli i dytë.

#### L I T E R A T U R A

- 1 — *Bajo I., Dafa F. (1984)* — Projekt për punimet e kërkim-zbulimit të fosforiteve jurasike. Gjirokastër.
- 2 — *Gucaj, A., Dafa F., Laska S., etj. (1984)* — Raport për kërkimin e fosforiteve të pasura në zonën Jonike.
- 3 — *Dafa F., Papuçiu A. (1984)* — Rreth rrozave të çarjeve dhe marrëdhënieve midis përbërësve të mineralizimit fosfatik jurasik. Bul. Shk. Gjeol., Tiranë, nr. 4.
- 4 — *Serjani A., Dafa F. (1987)* — Mbi radiolitostratigrafinë e depozitimeve mesozoike në zonën jonike. Bul. Shk. Gjeologjike, nr. 3.
- 5 — *Langora Ll., Husi R., (1981)* — Raport mbi punimet gjeologo-zbuluese në vendburimin «24 Maj». Gjirokastër.
- 6 — *Papuçiu A., Dafa F. (1987)* — Raport mbi punimet gjeologo-zbuluese në vendburimin «B» Tiranë. Gjirokastër.
- 7 — *Langora Ll., Nasi V. etj. (1970)* — Raport mbi rezultatet e punimeve gjeologo-radiometrike për kërkimin e mineraleve radioaktivë në zonën Jonike. Tiranë.
- 8 — *Kanani J. (1977)* — Litologja dhe kushtet e sedimentimit të depozitimeve të Jurasikut në zonën Jonike. Disertacion, Tiranë.
- 9 — *Nika Th. (1971)* — Mendime për praninë e pushimeve stratigrafike jurasike në zonën Jonike. Përmb. Studimesh, nr. 3.
- 10 — *Serjani A. (1986)* — Fosfatmbajtja e brezave antiklinalë të Kurveleshit e Çikës dhe perspektiva e tyre. Disertacion. Tiranë.
- 11 — *Kedhi M. (1988)* — Përcaktimi i izotopeve U-228, Ra-225, Th-232, dhe K-40, në mostra shkëmbore. Rap. Tek. IFB.
- 12 — *Lindeken C.L., COLOS D.G., Meadows J.W., Ge(Li) (1975)* — Spectrometric measurements of isotopic uranium Ratios in Solid treated with apatite-derived Ferti-Lizers; Në isotope ratios as pollutant source and behaviour indicators; IAEA.
- 13 — *LAU, H.M., Sakanoue M. and Komura J. (1982)* — Absoluta determination of uranium concentration By hyperpure Germanium Leps; Nucl. Instr. and Metl. 200.
- 14 — *Kedhi M. — Asbutk (1988)* — Analiza e spektrave gama të izotopeve U-238; Ra-226; Th-232; K-40 në mostra shkëmbore; Software, Rap. Tek. IFB.

*Summary**Determination of U, Ra, Th, K elements in the Mesozoic deposits of the anticline belt of Çika*

For the first time the summarized determinations of U, Ra, Th, K isotopes in the Mesozoic deposits of the anticline belt of Çika are given briefly. Their evaluation according to the dolomitic, carbonaceous-siliceous and flyschoidal complex has been made. The levels of the highest isotopic contents have been determined.

Fig. 1. The spectrum of the U-238 distribution.

Fig. 2. Generalized lithological-stratigraphic column of the belt of the structure of Çika with the values of U, Ra, Th, K elements.

## MINERALET ARGJILORE DHE NDIKIMI I TYRE NË THITHJEN E FOSFATEVE NGA TOKA

— Fioreta Luli\*, Agrikol Gjermani\* —

Në artikull bëhet fjalë për përbërjen e mineraleve argjilore në disa tipe tokash si dhe për aftësinë fiksuese të tyre për fosfor duke e përcaktuar këtë me metodën e kinetikës së hollimit izotopik.

### H Y R J E

Në mjaft punime të kryera në vende të ndryshme të botës ndjehet shqetësimi mbi shkallën e lartë të fiksimit të fosforit në tokat bujqësore (Fardeau J.C. etc. 1968, Guirand 1972, Gestuche M.C. etc. 1963, Gros A. 1962, Bauaw N.J. 1965) dhe, rrjedhimisht edhe për efektin e pakët të tij në rritjen e pjellorisë fosfatike të tokës dhe rendimentit të kulturave (Johuston A. 1972, Cook W. 1982, Sanchez P.A. Vehosa 1980). Faktorët e këtij fenomeni janë të shumtë si natyra e mineraleve argjilore pH, lënda organike etj.

Studimi i kryer në disa masive të vendit tonë për të përcaktuar shkallën e fuqisë fiksuese të tokës për jonet fosfate dhe nivelin fosfatik të tokës pas plehrimit tregoi se parcelat e analizuara ndryshojnë për sa u përket treguesve të mësipërm. Në disa prej tyre duhet të shtojmë deri në 1500 kg P<sub>2</sub>O<sub>5</sub>/ha dhe të mos arrijmë një shtesë në nivelin fosfatik të tokës me 1 mg/P<sub>2</sub>O<sub>5</sub> për 100 gr tokë, ndërsa në disa të tjera ky hop bëhet edhe vetëm me 100-150 kg P<sub>2</sub>O<sub>5</sub>/ha (Gjermani A. 1988).

Studimi mineralogjik i bërë në tokat bujqësore në ato livadhore të hirta kafe të vendit tonë, tregoi se përbërësit kryesorë mineralogjikë të tyre janë montmoriloniti, iliti dhe kaolini, ndërsa niveli i mineraleve të tjera në këtë tip toke është i ulët (F. Luli, 1987). Në punimin e mëposhtëm kërkojmë të njohim shkallën e ndikimit të seicilit mineral argjilor, në aftësinë e thithjes së plehut fosfatik për tokat e tipit livadhor të hinjta kafe.

\* Institut i Studimit të Tokave në Tiranë.

**Ndjeshmëria e fuqisë fiksuese pas plehrimit (A) dhe përbajtja e kaolinës të mostrës****Pasqyra 3**

Nr.	Emërtimi i profilit	Kaolina në %	$r_i^A/R (V_4)$
			$r_i/R (V_1)$
1.	Shkodër	5954	8
2.	Përmet	200	11
3.	Durrës	7541	14
4.	Korçë	201	24
5.	Elbasan	5674	27
6.	Tiranë	4	29
7.	Lushnje	4422	29
8.	Lushnje	2229	29
9.	Lezhë	2102	30
10.	Lezhë	2191	31

Shënim: Vlerat e raportit A, tregojnë raportin ndërmjet nivelistë fuqisë fiksuese të  $V_4$  ndaj  $V_1$ .

**L I T E R A T U R A**

1. *Gjermani A. (1988) — Mbi fiksimin e fosforit në tokë dhe disa masa agroteknike mbi uljen e tij.* Disertacion.
2. *Kokushta F. (1975) — Studimi i cilësive kimike e mineralogjike të tokave HKM të Tiranës.*
3. *Kokushta F. (1987) — Analizat X-difraktometrike në tokat bujqësore.* Bul. Shkencave Bujqësore.
4. *Koçi M. (1985) — Përcaktimi i përbërjes minerale të mineralizimit fosfatik të Jurasikut dhe Kretakut në zonën Jonike.* Disertacion.
5. *Luli F. (1985) — Karakteristikat mineralogjike të tokave livadhore të hinjtë kafe të Shqipërisë.* Disertacion.
6. *Serjani A. (1987) — Përbërja kimike dhe minerale e fosforiteve të brezit antiklinal të Kurveleshit.* Bul. Shk. Gjeol. nr. 1.
7. *Cooke G.W. (1982) — Fertilizing for maximum yield 34-37.*
8. *Fardeau J.C. et Guiraud P. (1972) — Determination of available soil and fertilizers phosphorus by the isotopic delution methode.* Phosphorus in agriculture 19-26.
9. *Fardeau J.C. (1974) — Utilisation des filtres millipor en chimie duso application à la caractérisation cinétiques de dilution isotopique des ions dans le sol.*
- 10 — *Kim e Tan Principe of, soil chemistry Gorgia 1982.*

*Summary*

The aim of this paper is to explain the influence of various components of clays in the absorption of phosphor of the phosphatic fertilizer winnowed during fertilization. The technics of the rapid filtration with filters «Swinex» combined with the marking of fertilizer with radioactive isotope ( $P^{32}$ ) has been used as an analytic means. There exist a good co-operation between the fixing power of the soil for the phosphate ions and the contents of the caolinite in clays. The influence of montmorillonite in this absorption is small. The small effect of superphosphate to the increasing of  $P_2O_5$  content (assimilated by the soil) and the productivity of crops is due to, the chemical nature of clays and mainly to the content of caoline and its components in clay.

## STRATIGRAFI-PALEONTOLOGJI

# STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE TË VERFENIANIT TË SIPËRM DHE ANIZIANIT NË RAJONIN E VERMOSHIT

— Thanas Gjata\*, Dedë Marku\*\*, Vangjel Kici\* —

Paragiten të dhëna lito- e biostratigrafike që saktësojnë stratigrafinë e shkëmbinjve të verfesianit të sipërm dhe anizianit në rajonin e Vermoshit. Këto saktësimë janë si rrjedhim i prerjeve të imtësuara stratigrafike, marshutprerjeve dhe vrojtimeve gjeologjike të kryera në këtë rajon. Saktësohet më mirë vendi stratigrafik i mineralizimeve të gjetura deri tanë.

### H Y R J E

Në kuadrin e studimeve stratigrafike për shkëmbinjtë mesozoikë (triasiko-jurasikë) të Albanideve Lindore, në rajonin e Vermoshit, u kryen disa prerje të imtësuara stratigrafike, marshrutprerje dhe vrojtime gjeologjike (fig. 1, 2) të cilat dhanë material të mjaftueshëm biostratigrafik për datimin moshor të shkëmbinjve që marrin pjesë në ndërtimin gjeologjik të këtij rajoni (11). Gjithashtu, analiza dhe sinteza e materialit të përfshuar saktësoi në pikëpamjen stratigrafike vendin e mineralizimeve që hasen në shkëmbinjtë e këtij rajoni, të cilat tani mund të kërkohen më me efektivitet.

Historiku i studiueshmërisë gjeologjike të rajonit të Vermoshit për punimet e kryera deri në vitin 1986 është dhënë gjerësisht më parë (11, 22), ndërkojë janë bërë studime dhe janë botuar dhe materiale të tjera si ajo e autorëve J. Kanani etj. (15), ku, ata, në kreun e prerjes datojnë edhe depozitime të një Ladiniani,?, për të cilat ne kemi mendimin se rezultojnë me moshë të Anizianit, A. Duraj, në studimet e tij (5, 6) jep përshtrim të imtësuar petrografik e petrokimik të shkëmbinjve vulkanik të këtij rajoni. Gjatë viteve 1987, 1988 në zbatim të projektit (22) punuan në rajonin e Vermoshit L. H. Peza, D. Shkupi etj.<sup>1)</sup>.

\* Instituti i Studimeve dhe Projekteve të Gjeologjisë në Tiranë.

\*\* Ndërmaria Gjeologjike e Pukës.

1) Shënim. Ndërkojë që ky material ishte në redaksi, në pritje për botim përfundoi studimi: «Stratigrafia, paleogeografi dhe konkretizimi i perspektivës për hekur në zonën e Vermoshit», në të cilin stratigrafisë së depozitimeve i bëhet përshtrimi i imtësuar litologo-petrografik për çdo prerje. Mendojmë se për disa ndarje kronostratigrafike autorëve u mungojnë argumentat faunistik siç është fjalë për nënkatin Sejs e Kampil si dhe për katin Ladinian. Depozitimet e Ladinianit mendojmë se nuk mund të datohen vetëm me faktin e gjetjes së një fragmenti Baccanella që autorët përmendin në studimin e tyre.

tën e gëlqerorëve pllakorë të zezë dhe shisteve argjilore të Jashicës e cila përbëhet prej dy pakosh litologjike.

b — Në anizian janë dalluar 6 suita që emrëtohen:

1 — Suita e gëlqerorëve të zezë të Kërshit të Djegur;

2 — e dolomiteve masivë të Zabelit, 3 — vullkanogjene e tufeve e andeziteve të Ballonës, që përbëhet prej dy pakosh: e poshtmja tutifike dhe e sipërmja andezitike; 4 — e gëlqerorëve nodularë të Seferçës, e cila përbëhet prej dy pakosh: e poshtmja e gëlqerorëve të kuq, e sipërmja e gëlqerorëve gri me silicorë e gëlqerorë brekçiorë; 5 — e radiolariteve të Çardakut dhe 6 — e andeziteve të sipërme të Mojanit.

III — Në Anizian, në këtë rajon, është zhvilluar magmatizmi efuziv-mesataro-acid, me prirje alkalinore. Ai paralelizohet me serinë efuzivo-sedimentare të triasikut të hershëm e ndërmjetmë të Albanideve Lindore.

a — Këta shkëmbinj kanë premisa, për mineralizime polimetaloore të Cu, Pb, Zn e Hg.

b — Shfaqjet e rëndësishme të hekurit pa nikел të lokalizuara në Majën e Bojës në suitën e dolomiteve masivë të Zabelit (Anizian) mendojmë se janë të tipit sedimentar.

IV — Rajoni i Vermoshit ka nevojë për studime të imtësuara stratigrafike e paleogeografike për një ecuri më me efektivitet në kërkimin e mineralizimeve të mundëshme e të pritëshme e sidomos për mineralin e hekurit pa nikel.

a — Për imtësimë më të detajuara stratigrafike duhet të përdoret studimi i konodonteve, të cilët mendojmë se duhet të janë të pranishëm sidomos në depozitimet karbonatike të prerjes.

b — Duhen bërë vëzhgime të veçanta paleogeografike si dhe studime të imtësuara mineralogjike e gjeokimike për shenjat e mineralizimeve të hasura si dhe të aplikohen metodat gjeofizike të kërkimit.

## L I T E R A T U R A

1. Bakri S. 1978 — Projekt mbi punimet e kërkim-rilevimit e kërkim-rezisionimit në zonën e Vermoshit dhe Trojanit gjatë viteve 1977-1978. Shkodër.
2. Bakri S. 1986 — Harta gjeologjike e rilevimit në shkallë 1:10.000 të zonës së Vermoshit (pa tekst shpjegues), Shkodër.
3. Beshic Z. 1980 — Geologia Crne Gore (Stratigrafia e falalin sistem). (Crne Gore), Titograd.
4. Dede S., Shallo M., etj. 1972 — Ndërtimi gjeologjik dhe mineralet e dobishëm të Shqipërisë së Veriut, Tiranë.
5. Duraj A. 1973 — Petrografia e shkëmbinjeve magmatikë të zonës së Vermoshit. Tiranë.
6. Duraj A. 1987 — Mbi përbërjen petrografike dhe petrokimike të shkëmbinjeve vullkanikë në zonën e Vermoshit. BSHGJ, nr. 3, Tiranë.
7. Dokic V. etj. 1970 — Geoloski sostav i tektonski Sklop Zijovoj Komova, Visitora i Severnin Prokletija. Geolo-glasnik t. VI. Titograd.
8. Grillo V., Turku I. etj. 1983 — Studim tematiko-përgjithësues dhe rilevues për kërkimin e polimetaleve në rajonin Dukagjin-Vermosh. Tiranë.
9. Grup autorësh 1983 — Harta gjeologjike e RPSSH në shkallë 1:200 000. Tiranë.

10. Grup autorësh 1982 — Tekst sqarues i Hartës gjeologjike të RPSSH në shkallë 1:200 000. Tiranë.
11. Gjata Th., Kici V. etj. 1985 — Studim mbi stratigrafinë e depozitimeve mesozoike (triasiko-jurasike) të Albanideve lindore dhe premisat për mineralmbajtjen e tyre. Tiranë.
